

**VENDIM**  
**Nr. 671, datë 12.11.2025**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË AKADEMISË “*NEHEMIAH GATEWAY*”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 7, dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbylljen e veprimtarisë së akademisë “*Nehemiah Gateway*”, e cila ka ushtruar veprimtarinë në qytetin e Pogradecit, me kërkesën e tij.

2. Akademia “*Nehemiah Gateway*” ka këto detyrime:

a) Të dorëzojë dokumentacionin ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon dhe mbi bazën e të cilit ka zhvilluar veprimtarinë e tij akademike e kërkimore-shkencore në strukturat përgjegjëse, në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

b) Të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

c) Të marrë masa që të heqë nga objekti i veprimtarisë së personit juridik fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Vula e akademisë “*Nehemiah Gateway*” asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e akademisë “*Nehemiah Gateway*”, në zbatim të këtij vendimi, përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/fondacioni “*Nehemiah Gateway Albania (NG Albania)*”, që e përfaqëson.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe akademia “*Nehemiah Gateway*”/fondacioni “*Nehemiah Gateway Albania (NG Albania)*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**